



FJALA E MIRËSEARDHJES

*Piroska Nagy Mohacsi**

*Të nderuar të ftuar,
Të nderuar pjesëmarrës dhe ndjekës të punimeve të kësaj konference,
I nderuar Guvernator Sejko!*

Faleminderit që na jeni bashkuar në konferencën e tretë të organizuar bashkërisht nga Banka e Shqipërisë dhe Instituti për Çështje Globale në LSE!

Në emër të LSE-së dhe drejtuesve të saj, më lejoni t'ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë!

Kjo konferencë është rezultat i bashkëpunimit tonë të vazhdueshëm intensiv. Ne filluam tri vite më parë, duke hartuar “Normalitetin e ri të politikës monetare”, teorinë monetare të re sipas politikave të jashtëzakonshme të bankave qendrore kryesore, menjëherë pas krizës financiare globale. Bëmë bashkë mendjet më të mëdha të kësaj fushe në kryeqytetin tuaj të mrekullueshëm, Tiranë.

Vitin e kaluar, u përqendruam në transformimin e sektorit financiar, me temë: “Një botë e re e guximshme”. Në të u diskutuan me imtësi çështje të lidhura me ndryshime në pronësinë e sektorit financiar,

* *Piroska Nagy Mohacsi, Drejtore e komanduar e Institutit për Çështjet Globale, Shkolla e Politikave Publike të LSE-së.*

aktorë të rinj, përfshirë nga sektori financiar jobankë, ide dhe produkte të reja, si dhe ndikimi i digjitalizimit në këtë sektor.

Disa muaj më parë, ne ishim mjaft optimistë - më pas pandemia COVID-19 goditi globin. Ndërsa diskutonim për temën e konferencës së këtij viti, nuk mund të mos analizonim ndikimin e COVID-19, sërish duke përfutur nga angazhimi i mendjeve më të mira të fushës. Konferenca e këtij viti po mbahet në mënyrë virtuale, nxitur nga nevoja për ruajtjen e shëndetit, por aksesimi virtual në web me natyrë globale, ofron lehtësinë që të ndiqet nga një audiencë edhe më e gjerë në rajonin e Evropës Jugore dhe në mbarë botën, se sa një organizim *on site* në Shqipëri.

Shpresojmë që kjo konferencë të kontribuojë për të kuptuar më mirë se si mund të përballemi me pandeminë e COVID-19; çfarë dimë dhe çfarë nuk dimë në lidhje me çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon në këtë krizë të jashtëzakonshme. Fokusi ynë i veçantë qëndron, natyrisht, në ndikimin e pandemisë në ekonominë e vogla të hapura, në vendet në zhvillim në Evropë, dhe në veçanti në vendet e rajonit të Evropës Juglindore, të cilat janë në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Shpresojmë që ky proces të kuptuarit të ofrojë për hartuesit e politikave në Bruksel dhe në Frankfurt, pra në BQE, informacionin e nevojshëm për të forcuar dhe intensifikuar më tej përpjekjet për të mbështetur përgjigjen ndaj krizës, pikërisht në këtë rajon. Në këtë konferencë virtuale kemi dy panele fantastike: i pari ravijëzon skenën në kontekstin e të kuptuarit tonë të ndikimit të COVID-19 në ekonominë reale dhe gjithçka mund të mendojmë jashtë politikës monetare; kjo e fundit do të trajtohet në panelin e dytë: paneli tradicional i guvernatorëve. Në këtë panel do të kemi të pranishëm disa prej guvernatorëve kryesorë evropianë, të cilët jam e sigurt që do të kontribuojnë me mendime të vëra për diskutimin tonë. Në fund shpresojmë të dalim me më shumë njohuri dhe me perspektivën për të qenë më të përgatitur për çka vjen në vijim, e që me gjasë do të jetë një valë e re e pandemisë dhe një tërësi e re masash stimuluese.

Thënë kjo, dëshiroj t'i jap fjalën mikut dhe kolegut tim, Profesor Erik Berglof, i cili ka qenë një nga kumbarët e kësaj konference të përbashkët. Ai vijon ende bashkëpunimin me LSE-në, por tashmë mban edhe një pozicion në Bankën Aziatike të Investimeve Infrastrukturore (*Asian Infrastructure Investment Bank - AIIB*), në Pekin.